



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2456/2 prot.

Datë 03.09.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomik “Filara SHPK; “Inpress” SHPK; “Shtepia Botuese, Shtypshkronja MORAVA” SHPK; “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-11979-07-03-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me fond limit 22,099,417.66 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
- Ankimues:** “Kristalina-KH” SHPK me NIPT K11501002D, & dhe adresë: LORD BAJRONI -LAPRAKE
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
Adrese: Blv ”Dëshmorët e Kombit” NR.3, 1001, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** FILARA SHPK me Nipt K51611059N dhe adresë: Adresa: Tirane, Rruga Kavajes, Ish kombinati "Misto Mame", Prane fabrikes "Kaon".
- INPRESS SHPK me Nipt L52122014L dhe adresë: Adresa: Tiranë, Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra
- Shtepia Botuese, Shtypshkronja MORAVA, NIPT J82019001J dhe adresë: 1. Tirane, Rruga Gjin Bue Shpata, Bar-kafe libri prane Stadiumit Dinamo

OPTIMA COMMUNICATION SHPK me, NIPT
K71903025A dhe adresë: Rruga Vaso Pasha, P. 2, Shk. 2,
Ap. 7/1, kati i dyte.

Në datën 02.09.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4515 si dhe nr. Protokolli 2456/2024 datë 02.09.2024 i operatorit ekonomik “Kristalina-KH” SHPK për procedurën e prokurimit E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-11979-07-03-2024, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me fond limit 22,099,417.66 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 05-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga “Filara SHPK; “Inpress” SHPK: “Shtepia Botuese, Shtypshkronja MORAVA” SHPK; “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”*.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime se ofertuesit “Filara SHPK; “Inpress” SHPK: “Shtepia Botuese, Shtypshkronja MORAVA” SHPK; “Optima Communication” SHPK nuk përmbushin kërkesat/kriteret si me poshte:

“FILARA” SHPK nuk përmbush:

-Ofertë Anomalisht e Ulet.

-Nese do te hynim ne detaje tek sqarimi qe mund te kete derguar OE Filara ne zbatim te kerkeses te AK per te argumentuar vleren anomalisht te ulet kemi bindjen qe ky OE ekonomik ka bere gabime aritmetike.

Nuk ka arritur ta argumentojte oferten e tij anomlaisht te ulet.

“Prandaj ne konkluzion te kesaj pjese kerkojme hetim te thelluar nga AK dhe KPP per kete oferte pasi bazuar ne kete oferte kemi te bejme: ? Mosllogaritje reale e bazes materiale ? Mosvendosje e cmimeve reale te bazes materiale bazuar ne oferta/fatura te perditesuara ? Mosvendosje reale e cmimeve te materialeve ndihmese ? Mospasqyrim real I fondit te pagave dhe sigurimeve shoqerore, qirase se objektit, dritave, tatim fitimit ? Mos pasqyrim I kospos se qerase se makinerive”

Lidhur me skualifikimin e operatoreve ekonomik “Filara; Inpress ; Morava dhe OPTIMA COMMUNICATION” SHPK për mospermbushje te kriterëve:

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimalisht pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- Makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm; 2 (dy) copë
- Makinë qepëse 2 (dy) copë
- Makinë telefoni; 2 (dy) cope

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e e shërbimit objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) 1 (një) përgjegjës shërbimi,
- b) 1 (një) punonjës grafik- dizajner
- c) 2 (dy) punonjës ndihmës,
- d) 1 (një) shofer.

Për punonjësit në pikat a dhe c duhet të paraqitet: kontratë pune, të vlefshme.

Për punonjësin në pikën b duhet të paraqitet:

- diplomë e shkollës së lartë dhe/ose Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar, që vërteton se punonjësi ka njohuri në fushën e grafik-dizajnit;
- kontratë pune, të vlefshme

Për shoferin duhet të paraqitet:

- kontratë pune, të vlefshme,
- Leje drejtimi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 03.09.2024

	KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK			
Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	
Fiorent Zguro	Gjergj Mersini	Kreshnik Ternova	Anila Malaj	
	Kryetar			
	Jonaid Myzyri			